



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE

Data: 31 Maj 2022

Nr: 19

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE
NR. 01, DATË 23.05.2022 DREJTUAR KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE, PËR VENDOSJE SANKSIONI ADMINISTRATIV

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 31.05.2022, me pjesëmarrjen e:

Illirjan RUSMALI - Relator
Elvin LAKO - Anëtar
Elvis ÇEFA - Anëtar
Ledio BRAHO - Anëtar

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga administrata e KQZ-së,

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

OBJEKTI: Vendosja e sanksionit administrativ ndaj zj. Eriselda Sefa, kandidate për kryetare bashkie në zgjedhjet për kryetarin e bashkisë Lushnjë, të datës 06 Mars 2022

BAZË LIGJORE: Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; neni 34, shkronja “b” dhe neni 35 të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të

Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”; vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Rrethanat e çështjes:

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vënë në lëvizje Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve me kërkesën e tij nr.1, datë 23.05.2022, me objekt vendosjen e sanksionit administrativ ndaj kandidates për kryetare bashkie për Bashkinë Lushnjë, të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, në zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars 2022.
2. Kërkesa u paraqit në përfundim të hetimit administrativ të kryer nga Komisioneri bazuar në denoncimin me numër ID 3598 të datës 26 shkurt 2022, të depozituar në portalin e denoncimeve nga organizata “Qëndresa Qytetare” kundër zj. Ogerta Manastirliu, Ministre e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë dhe zj. Eriselda Sefa, kandidate për kryetare bashkie për Bashkinë Lushnjë. “Qëndresa Qytetare” denonconte subjektet e sipërcituar për shkelje të dispozitave të neneve 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, për shkak se kanë marrë pjesë (sipas denoncimit) në një veprimtari të ndaluar, takim elektoral në ambientet e spitalit “Ihsan Çabej” të Lushnjës, ku kanë promovuar investimet me interes publik, si dhe nuk kanë njoftuar paraprakisht në ndërfaqen e raportimeve të KQZ-së për kryerjen e veprimtarisë.
3. Komisioneri ka konkluduar në analizën ligjore të çështjes se, “veprimtaria e kryer në Spitalin e Lushnjës, është një veprimtari me karakter jo publik pasi është kryer vetëm ndërmjet palëve të interesuara dhe institucioneve organizuese. Publikimi i takimit dhe informimi i publikut nëpërmjet Agjencisë Telegrafike Shqiptare si e vetmja agjenci zyrtare që informon publikun mbi aktivitetin e vendit, duhet të shihet në kuadër të transparencës së aktiviteteve të institucioneve publike”. Në gjykimin e Komisionerit, veprimtaria nuk mund të trajtohet si veprimtari e ndaluar, për shkak se Ministrja e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale ka qenë në ushtrim të funksioneve të veta në një institucion varësie. “Institucionet publike nuk ndalojnë veprimtarinë e tyre gjatë periudhës zgjedhore dhe kryerja e detyrave të tyre funksionale nuk

mund të shihet si veprimtari e ndaluar thjesht sepse është e kryer gjatë kësaj periudhe” thekson Komisioneri në vendimin e tij nr.168, datë 19.05.2022.

4. Pavarësisht se ndaj deputetit Taulant Balla, “Qëndresa Qytetare” nuk kishte kërkuar vendosjen e sanksioneve administrative, Komisioneri e ka gjetur me vend të shprehet për statusin procedural të tij. Në analizën ligjore të rastit, Komisioneri ka vlerësuar se deputeti nuk përfshihet në rrethin e subjekteve të përcaktuara në nenin 3, pika 2 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Prandaj Komisioneri ka konkluduar se deputeti Taulant Balla nuk mund të jetë subjekt i hetimit administrativ. Po kështu, drejtori i Spitalit të Lushnjës “Ihsan Çabej”, z. Perin Vogli, ndaj të cilit fillimisht nuk ishte kërkuar vendosja e sanksionit administrativ është përfshirë në hetim. Lidhur me drejtorin e spitalit, Komisioneri ka dalë në përfundimin se ai nuk ka pasur dijeni për kryerjen e fushatës elektorale nga ana e kandidatës për kryetare bashkie zj. Sefa në institucionin që ai drejton. Prandaj Komisioneri është mjaftuar me tërheqjen e vëmendjes se “ky institucion, duhet të tregojë kujdes të shtuar për mospërsëritjen e rasteve të tilla”.
5. Komisioneri ka përjashtuar nga hetimi administrativ, pa shpjegim dhe as arsyetim, subjektin Partia Socialiste e Shqipërisë, pavarësisht se ky subjekt bënte pjesë në radhën e subjekteve të denoncuara për këtë ngjarje.
6. Komisioneri ka çmuar se nga hetimi administrativ i kryer dhe nga provat materiale të administruara në dosjen hetimore administrative, rezulton e provuar se zj. Eriselda Sefa, kandidate për Kryetare e Bashkisë Lushnjë, “me përdorimin e ambienteve të Spitalit Lushnjë dhe me përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore brenda orarit të punës për veprimtari dhe/ose aktivitete për qëllime zgjedhore dhe për kryerjen e takimit elektorale, ka përdorur burime publike në mbështetje të fushatës së saj zgjedhore, në kuptim të nenit 91, pika 1, e Kodit Zgjedhor”. Për këtë arsye ai i është drejtuar KAS-it me kërkesën për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zj. Eriselda Sefa në vlerën 50 mijë lekë, në përputhje me nenin 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
7. Pas paraqitjes së kërkesës nr.1, datë 23.05.2022 të Komisionerit, KAS-i caktoi me short anëtarin Ilirjan Rusmali relator të çështjes dhe në seancën e datës 27.05.2022, e cila u zhvillua me praninë e sekretarit të përgjithshëm të KQZ-së dhe të përfaqësuesve të organizatës “Qëndresa Qytetare”

(palët e tjera të njoftuara rregullisht, në mungesë) vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim dhe caktimin e seancës së shqyrtimit në datën 31.05.2022, ora 11:00.

8. Në seancën e shqyrtimit u paraqitën dhe parashtruan pretendimet e tyre:

- Administrata e KQZ-së, përfaqësuar me autorizim të Sekretarit të Përgjithshëm nga zj. Blerta Ereqi;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale zj. Ogerta Manastirliu, përfaqësuar me autorizim nga zj. Antoneta Njehrrëna dhe zj. Nexhilda Kodra;
- Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zj. Gelardina Prodani, përfaqësuar me autorizim nga zj. Antoneta Njehrrëna dhe zj. Nexhilda Kodra;
- Organizata “Qëndresa Qytetare”, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, z. Rigels Xhemollari dhe zj. Teisa Kurti.
- Subjekti Zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, kandidatja për kryetare e Bashkisë Lushnjë zj. Eriselda Sefa dhe drejtori i Spitalit të Lushnjës “Ihsan Çabej”, z. Perin Vogli të njoftuar rregullisht nga administrata e KQZ-së janë në mungesë.

9. KAS-i mori në shqyrtim, këqyri dhe administroi me cilësinë e provës:

- denoncimin nr. ID 3598, datë 26 shkurt 2022 të organizatës “Qëndresa Qytetare” (sipas paraqitjes në portalin e denoncimeve dhe paraqitjes në protokollin e KQZ-së);
- shkresën nr.1099/1 prot., datë 04.03.2022 të Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe shkresën nr.1672/1 prot., datë 14.04.2022 të Sekretares së Përgjithshme Gelardina Prodani;
- shkresën e zj. Eriselda Sefa të datës 03.03.2022 drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, protokolluar me nr.1297/2, datë 07.03.2022;
- shkresën nr.1964/1, datë 10.03.2022 të Kryetares së Bashkisë Lushnjë drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;

- shkresën nr.372, datë 10.03.2022 të drejtorit të spitalit “Ihsan Çabej” Lushnjë, z. Perin Vogli drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- Provat Link:

<https://www.facebook.com/114450444485182/posts/118339360762957/>

<https://ata.gov.al/2022/02/16/manastirliu-dhe-balla-investime-te-tjera-ne-spitalin-e-lushnjes/>

<https://fb.watch/bgMLyg8WDS/>

<https://www.facebook.com/b.taulant/posts/483537039804507>

<https://www.facebook.com/OgertaManastirliu/posts/484024386427736>

<https://ww.balkanweb.com/balla-me-manastirliun-ne-spitalin-e-lushnjes-investimet-e-rejadhe-zgjerimi-i-sherbimeve-pergjigja-per-thashethemet-keqdashese/>

<https://fjala.al/2022/02/16/balla-dhe-manastirliu-ne-spitalin-e-lushnjes-investimet-e-rejapergjigja-per-thashethemet-keqdashese/>

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-i konstatoi:

1. Pika 1, e nenit 92 të Kodit Zgjedhor ka dhënë kuptimin e veprimtarisë publike në fushatë. Sipas këtij përkufizimi, “formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”. Që veprimtaria të quhet publike, sipas kuptimit të kësaj dispozite, ajo nuk duhet domosdoshmërisht të jetë miting, tubim, mbledhje apo grumbullim i thirrur dhe i organizuar me synim pjesëmarrjen e publikut. Mjafton që ajo të jetë e “hapur”, d.m.th. të mos zhvillohet “pas dyerve të mbyllura”. Nuk ka nevojë që publiku apo media të thirren, të ftohen apo të mobilizohen për të marrë pjesë në veprimtari që ajo të quhet publike. Mjafton që ata të kenë akses dhe të mos ndalohen kur i qasen asaj. Nga ana tjetër, veprimtaria bëhet publike sipas kuptimit të kësaj dispozite, edhe në

rastet kur ajo zhvillohet “pas dyerve të mbyllura”, por ama synon dhe realizon në fakt informimin e publikut për temat, diskutimet dhe përfundimet e agjendës së saj.

2. Për të kuptuar nëse veprimtaria e denoncuar me denoncimin nr. ID 3598, të datës 26 shkurt 2022 është veprimtari publike ose jo është e nevojshme të këqyren dhe çmohen pamjet dhe fotot që i referohen kësaj veprimtarie dhe që janë referuar si prova në denoncim. Pamjet dhe fotot shfaqin një vizitë/inspektim në mjediset e punës (salla shtrimi, salla vizitash dhe laboratore) dhe hapësirat publike të spitalit “Ihsan Çabej” të Lushnjës. Pothuajse të gjitha mjediset e vizituara janë, për shkak të funksionit, mjedise të hapura për publikun, sikurse nga pamjet duket qartë se spitali nuk është mbyllur për publikun, për shkak të kësaj veprimtarie. Gjatë kësaj vizite, dinjitarët shihet të takojnë dhe ndërveprojnë me stafin mjekësor por edhe me pacientë, të cilët janë duke marrë shërbime në këtë spital. Takimet duken të hapura, spontane dhe pa protokoll. Për më tepër, nuk ka asnjë indicie që të lërë të kuptohet se regjistrimi në video i veprimtarisë dhe fotot e nxjerra prej saj të jenë të improvizuara apo të kryera nga duar amatore. Përkundrazi, në pamjet video shfaqen edhe individë me kamera apo aparate fotografike, gjë që nënkupton prezencë të medias në këtë veprimtari. Pasqyrimi i veprimtarisë nga gazetarja Arlinda Gjonaj e Agjensisë Telegrafike Shqiptare dhe nga portalet balkanweb.com dhe Fjala.al, në edicionet e datës 16 shkurt 2022 e përforcon këtë perceptim.

3. Mesazhet e përcjella nga dinjitarët në këtë veprimtari janë të qarta:

- “Do të vijojmë investimet në të gjithë rrjetin e spitaleve në vend, për të garantuar shërbim cilësor për qytetarët, afër vendbanimit” (Ministrja e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale);
- “Spitali i Lushnjës ka një status të veçantë për shkak të numrit të madh të banorëve dhe shërbimeve që ofron. Prandaj ne do të vazhdojmë të investojmë edhe më shumë në këtë qendër të rëndësishme spitalore, me qëllim garantimin e çdo shërbimi të specializuar” (Drejtuuesi Politik i Qarkut Fier);
- “Si Kryetare e Bashkisë Lushnjë, gjej rastin të falenderoj Kreun e Grupit Parlamentar të PS, Taulant Balla dhe Ministren Manastirliu të cilët premtuan angazhimin konkret të qeverisë që godina e #SpitaliLushnjë të rikonstruktohet, por gjithashtu të zgjerohen shërbimet e specializuara nisur nga numri i madh i pacientëve që pret çdo ditë!” (kandidatja e PS për kryetare bashkie)

Këto mesazhe janë të karakterit elektoral, janë dhënë në një veprimtari të hapur për publikun dhe median dhe janë përcjellë në këtë formë nga media.

4. Komisioneri ka pranuar pretendimin e shprehur nga Drejtori i Spitalit dhe Kryetarja e Bashkisë se veprimtaria e denoncuar ishte veprimtari e organizuar “si një takim konsultues me mjekët specializantë të këtij spitali, të cilët janë në përfundim të kontratës së tyre” (shkresa nr.1964/1, datë 10.03.2022 e Kryetares së Bashkisë Lushnjë drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve), “për të trajtuar/diskutuar rreth bonusit të qirasë për banesat e mjekëve, të cilët nuk janë me banim në Bashkinë Lushnjë” (vendimi i Komisionerit nr.168, datë 19.05.2022). Ky fakt i ka mjaftuar Komisionerit që t’ a fusë veprimtarinë e denoncuar brenda kontureve të detyrave funksionale të ministrit dhe të kryetarit të bashkisë dhe t’ a klasifikojë atë si veprimtari jo publike. Subjektet e denoncuar kur flasin për “takim konsultë” ose i referohen një ngjarjeje tjetër, e cila mund të ketë pasuar veprimtarinë e denoncuar, ose i referohen një ngjarjeje që nuk ka ndodhur kurrë. Hetimi i “takimit konsultë” nuk mund të jetë lëndë e këtij hetimi administrativ, sepse nuk është objekt i denoncimit. Objekt i denoncimit është vizita/ inspektimi në mjediset e punës (salla shtrimi, salla vizitash dhe laboratore) dhe hapësirat publike të spitalit “Ihsan Çabej” të Lushnjës.
5. Veprimtaria e denoncuar është veprimtari elektorale e zhvilluar në mjediset e spitalit nga drejtuesi politik i qarkut, ministrja e shëndetësisë dhe e mbrojtjes sociale dhe kandidatja për kryetare bashkie. Veprimtaria është riprodhuar në video nga momenti kur dinjitarët mbërrijnë në mjediset e jashtme të spitalit, deri në momentin kur largohen prej tyre. Dialogjet dhe prononcimet e regjistruara nuk bëjnë fare fjalë për lëndën e pretenduar të “konsultës me mjekët”. Për më tepër, nëse do të merrej për një moment si i vërtetë dhe i pranueshëm pretendimi i “konsultës”, atëherë nuk justifikohet dot prezenca në këtë veprimtari e drejtuesit politik të qarkut Fier. Për më tepër, pretendimi rrëzohet edhe nga shkresa e vetë kandidates për kryetare bashkie zj. Eriselda Sefa e datës 03.03.2022 drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, protokolluar me nr.1297/2, datë 07.03.2022. Në pikën 9 të kësaj shkrese, kandidatja për kryetare bashkie shprehet: “Sikurse rezulton edhe nga deklarimet e zotit Balla prezenca jonë në spital ka qenë tërësisht në funksion të premtimeve për zgjedhjet vendore në Lushnjë”.
6. Për këto arsye, arsyetimi i Komisionerit se veprimtaria ka qenë veprimtari institucionale jo publike nuk ka bazë faktike dhe ligjore, prandaj nuk mund të pranohet nga KAS-i. Veprimtaria ka qenë publike dhe institucionet e përfshira kanë pasur detyrimin për raportim, në përputhje me pikën 1 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Sipas pikës 2 të të njejtit nen “raportimi është përgjegjësi

personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve publike, agjencive dhe ndërmarrjeve shtetërore (sekretarit të përgjithshëm të institucionit ose, sipas rastit, e drejtorit të përgjithshëm apo drejtorit ekzekutiv)”. Për Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale, personi përgjegjës është Sekretari i Përgjithshëm. Ai është person i ngarkuar me detyra në kuptimin e pikës 1, të nenit 171 të Kodit Zgjedhor. Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zj. Gelardina Prodani, sikurse rezulton nga dosja e hetimit administrativ nuk u përfshi nga Komisioneri në këtë hetim administrativ, sepse Komisioneri e ka rrëzuar në parim dhe apriori denoncimin për mosraportim të kësaj veprimtarie.

7. Raportimi i veprimtarive të institucioneve në periudhën e ndalimit është një mekanizëm kyç i Kodit Zgjedhor për të penguar keqpërdorimin e burimeve shtetërore dhe për të ndihmuar KQZ-në që të ruajë barazinë mes palëve në garë, nëpërmjet ndalimit të veprimtarive publike, të cilat kërkohet të zhvillohen në kundërshtim me rregullat e vendosura nga Kodi. Duke mos raportuar veprimtarinë e Ministres, Sekretarja e Përgjithshme e kësaj ministrie ka penguar Komisionerin që të shqyrtojë paraprakisht ligjëshmërinë e kësaj veprimtarie dhe të urdhërojë eventualisht ndalimin e saj. Masa e sanksionit që mund të vendoset, brenda limiteve të përcaktuara nga pika 1 e nenit 171 të Kodit Zgjedhor, duhet të marrë në konsideratë rëndësinë e posaçme të marrëdhënies juridike të cënuar, sikurse duhet të çmojë drejt edhe faktin se mekanizmi ligjor që mbron interesin publik zgjedhor nga keqpërdorimi i burimeve shtetërore është ende në fazën fillestare të zbatimit dhe se, në shumicën e rasteve, cënimi vjen jo nga keqdashja, por nga keqkuptimi ose mosnjohja e detyrimit.
8. Kandidatja për kryetare bashkie e Bashkisë Lushnjë ka pasur status të dyfishtë në periudhën e raportimit, kryetare në detyrë dhe kandidatë. Por Komisioneri ka vepruar drejt kur ka çmuar se për veprimet e saj ajo duhet konsideruar me cilësinë e saj si kandidatë dhe jo si kryetare në detyrë. Veprimtaria ka qenë veprimtari elektorale e kandidatit dhe jo veprimtari e bashkisë. Për këtë arsye, mbi institucionin e Bashkisë Lushnjë nuk mund të bjerë detyrimi për raportim, sa kohë që titullari vepron në cilësinë e kandidatit.
9. Provat dhe analiza e mësipërme e veprimtarisë së denoncuar demonstrojnë qartë se veprimtaria ka qenë veprimtari elektorale e kandidatës për kryetare bashkie, e zhvilluar në mjediset e një institucioni publik, me pjesëmarrjen e stafit të institucionit, në orarin e zakonshëm të punës në këtë institucion. Kjo veprimtari ka cënuar ndalimin e shprehur të pikës 1, të nenit 91 për mospërdorimin e aseteve publike në fushatë dhe të administratës publike në veprimtaritë e

fushatës. Shkronjat “c” dhe “ç” të pikës 1.3 të vendimit të Rregullatorit nr.9, datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” e klasifikojnë këtë veprimtari si veprimtari të ndaluar në kuptim të dyfishtë.

10. Për veprimtaritë e ndaluara Kodi Zgjedhor ngarkon me përgjegjësi subjektet zgjedhore. Pika 1, e nenit 172 përcakton se “subjektet zgjedhore kryejnë kundërvajtje administrative në rastet kur në favor të tyre kryhen shkelje të ndalimeve të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji dhe subjektet zgjedhore, pas marrjes dijani, nuk marrin masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes”. Kushti që duhet të vërtetohet nga hetimi është që veprimtaria të jetë kryer në favor të subjektit zgjedhor d.m.th. subjekti zgjedhor të ketë siguruar përfitim elektoral nga shkelja dhe që ky i fundit të mos ketë marrë masa për ndërprerjen e shkeljes, pas marrjes dijani.
11. Kodi Zgjedhor, në pikën 20 të nenit 2 përcakton se “subjekte zgjedhore” janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod”. Zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars 2022 ishin zgjedhje për kryetar bashkie, por jo për këshillat bashkiake. Për shkak se kandidati për kryetar bashkie trajtohet nga Kodi si subjekt zgjedhor i mëvetësishëm, atëherë në këto zgjedhje duhet trajtuar subjekt zgjedhor përfitues kandidati dhe jo partia politike që e mbështet atë. Arsyeimi do ishte i ndryshëm në rastin e zgjedhjeve të rregullta periodike kur zgjidhen si kryetarët e bashkive, ashtu dhe këshillat bashkiake. Në këtë rast, veprimtaria e ndaluar sjell përfitim si për subjektin kandidat (vota për kryetarin e bashkisë) ashtu dhe për subjektin parti ose koalicion (vota për listën e këshillit). Në këto kushte, KAS-i çmon se subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë nuk mund të përfshihet në këtë procedim administrativ, pavarësisht se ajo ka qenë subjekt i denoncimit.
12. Komisioneri e ka konsideruar kandidatin për kryetar bashkie “subjekt zgjedhor përfitues nga shkelja” së paku në rastin e vendimit të tij nr.152, datë 28.04.2022, kur ka vendosur sanksion administrativ ndaj kandidates për kryetare bashkie për Bashkinë Durrës, zj. Emirjana Sako. Në rastin e kërkesës objekt shqyrtimi, Komisioneri ka hequr dorë nga ky standard dhe e ka konsideruar kandidaten “person i ngarkuar me detyra”, sepse ka kërkuar vendosjen e sanksionit administrativ që parashikon pika 1, e nenit 171 të Kodit Zgjedhor dhe jo pika 1, e nenit 172 të

tij. KAS-i çmon se standarti i gjykimit duhet të ruhet, sepse ky është element thelbësor i drejtësisë. Kandidati për kryetar bashkie është subjekt zgjedhor dhe duhet të trajtohet si i tillë edhe kur objekt shqyrtimi janë shkeljet eventuale të ligjit dhe sanksionet respektive.

13. Kandidatja për kryetare e bashkisë Lushnjë, zj. Eriselda Sefa ka organizuar veprimtarinë në spitalin “Ihsan Çabej” në kuadër të fushatës së vet elektorale, sikurse e pohon vetë në shkresën e datës 03.03.2022 drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, protokolluar me nr.1297/2, datë 07.03.2022. “Në vijim të fushatës dhe premtimeve zgjedhore nuk mund të shmangnim as qytetarët që marrin kurim në spital”, shkruan ajo në pikën 7 të kësaj shkrese. Ajo ka qenë në qendër të kësaj veprimtarie, personazh kryesor i saj. Kandidatja ka pasur dijeni dhe nuk ka marrë masa për ndërprerjen e shkeljes, prandaj duhet të trajtohet si subjekt i veprimit të pikës 1, të nenit 172 të Kodit Zgjedhor. Në caktimin e masës së sanksionit, KAS-i duhet të çmojë dhe t’i japë peshën që i takon faktit se mekanizmi mbrojtës ndaj keqpërdorimit të burimeve shtetërore është ende në fazën fillestare të zbatimit dhe se, në shumicën e rasteve, cënimi vjen jo nga keqdashja, por nga keqkuptimi ose mosnjohja e detyrimit. Këtë qëndrim KAS-i e ka mbajtur edhe në rastin e vendimit të tij nr. 18, datë 27.05.2022, sepse e gjen atë në harmoni me shkronjën “a”, të pikës 2 të nenit 172 të Kodit Zgjedhor, në këtë fazë të zbatimit të dispozitës.
14. Ministrja e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale zj. Ogerta Manastirliu ka marrë pjesë në një veprimtari të ndaluar në kuptimin e shkronjave “c” dhe “ç” të pikës 1.3 të vendimit të Rregullatorit nr.9, datë 24.12.2020. Por kjo veprimtari nuk ka qenë e shpallur e ndaluar nga Komisioneri, sikurse kërkon neni 9 i vendimit nr.9, datë 24.12.2020 të Rregullatorit. Ministrja e Shëndetësisë mund t’i nënshtrohet sanksionit administrativ sipas kuadrit ligjor në fuqi vetëm nëse “ka penguar raportimin, ka ndikuar apo urdhëruar që ai të raportohet me vonesë, apo veprimtaria apo aktiviteti publik është zhvilluar pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve” (pika 2 e nenit 10 të vendimit nr.9, datë 24.12.2020 të Rregullatorit). Si denoncimi, ashtu dhe hetimi administrativ i kryer nga Komisioneri nuk përmbajnë asnjë të dhënë që të indikojë përgjegjësi të Ministres në këtë drejtim. Për këtë arsye, KAS-i gjykon së ndaj Ministres Manastirliu nuk mund të vendosen sanksione administrative për veprimtarinë e denoncuar.
15. KAS-i nuk e gjen as të mbështetur në rrethanat e faktit, as të justifikueshëm ligjërisht qëndrimin e Komisionerit lidhur me rolin e drejtorit të spitalit “Ihsan Çabej”, z.Perin Vogli. Komisioneri në kërkesën e tij drejtuar KAS-it është shprehur se për të “rezultoi e provuar nga materialet e

dosjes se Drejtori i Spitalit të Lushnjës “Ihsan Çabej”, z. Perin Vogli, nuk ka pasur dijeni për kryerjen e fushatës elektorale nga ana e kandidatës për kryetare bashkie zj. Sefa në institucionin që ai drejton”, në një kohë që provat demonstrojnë se drejtori i spitalit ka qenë mikpritësi dhe shoqëruesi i dinjitarëve përgjatë gjithë veprimtarisë së denoncuar. Edhe në pikëpamje të analizës ligjore pozicionimi i Komisionerit në favor të drejtorit është i papranueshmë nga KAS-i. Për veprimtari elektorale që zhvillohen në institucione publike prezumimi duhet të jetë gjithmonë se drejtuesi i institucionit ka dijeni, sepse kjo është pjesë e rrethit të detyrave të veta. Nga ky prezumim mund të hiqet dorë vetëm nëse provat e administruara dëshmojnë mungesën e dijenisë për veprimtarinë. Në dosjen hetimore nuk ka asnjë të dhënë që të rrëzojë këtë prezumim. Përkundrazi, provat e administruara (pamjet video dhe fotot, si dhe shkresa nr.372, datë 10.03.2022 e drejtorit të spitalit “Ihsan Çabej” Lushnjë, z. Perin Vogli drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve) e vendosin drejtorin në qendër të ngjarjes së denoncuar. Prandaj KAS-i gjykon se drejtori i spitalit duhet të mbahet përgjegjës për lejimin e veprimtarisë elektorale në mjediset e institucionit të tij dhe të sanksionohet sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 171 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në arsyetimin e mësipërm ligjor dhe bazuar në shkronjën “dh”, të pikës 1 dhe në pikën 3, të nenit 21 të Kodit Zgjedhor, KAS-i me shumicë votash

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës nr.1, datë 23.05.2022 të Komisionerit për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj kandidatës për kryetare të Bashkisë Lushnjë, zj. Eriselda Sefa dhe vendosjen e sanksionit administrativ mbështetur në pikën 1, të nenit 172 të Kodit Zgjedhor në vlerën 100000 (njëqindmijë) Lekë.
2. Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zj. Gelardina Prodani mbështetur në pikën 1, të nenit 171 të Kodit Zgjedhor në vlerën 25000 (njëzet e pesëmijë) Lekë.

3. Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj Drejtorit të Spitalit “Ihsan Çabej” Lushnjë, z. Perin Vogli mbështetur në pikën 2, të nenit 171 të Kodit Zgjedhor në vlerën 2500 (dymije e pesëqind) Lekë.
4. Pushimin e procedimit administrativ ndaj subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.
5. Pushimin e procedimit administrativ ndaj Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zj. Ogerta Manastirliu.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar (Kundër)
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar